

GJUHA DHE STILI NË KRIJIMTARINË LETRARE MODERNE DHE POSTMODERNE TË REXHEP QOSJES, SIPAS SHEFKIJE ISLAMAJ

Melihate ZEQIRI

Prishtinë
melihatez@gmail.com

Abstrakt

Krijimtaria e tij letrare dhe artistike e identifikon shkrimtarin Rexhep Qosja si nismëtarin dhe përfaqësuesin më të veçantë të postmodernizmit në letërsinë shqipe. Nga studiuesit e veprës së tij artistike, ai konsiderohet njëri ndër përfaqësuesit më të veçantë të letërsisë postmoderne shqipe. Romanet e tij dallojnë prej romaneve të letërsisë shqipe për mënyrën si i bashkojnë ato imagjinaren e njëmendësinë, për mënyrën e formësimit artistik, për përdorimin e veçantë të gjuhës e të stilit dhe për estetikën e tyre në përgjithësi. Romanet e Rexhep Qosjes ofrojnë mundësi të pakufishme për të interpretuar tema, subjekte, ide, personazhe e sidomos strukturën e brendshme të të gjitha kuptimeve asociative e simbolike deri te pasuria e pashtershme gjuhësore e stilistike.

Gjuha dhe stili i shkrimtarit Rexhep Qosja përmban, stilistikën leksiko-semantike, stilistikën sintaksore, stilistika tekstore-ligjërimore, figurshmëria dhe teknika postmoderne. Qosja me prozën e tij artistike, me gjuhën dhe stilin, ia ka siguruar vetes paharresën dhe vendin e çmuar në “mbretërinë” e letërsisë shqiptare.

Rexhep Qosja është krijues i madh me vëllimin e veprave, me vizionin largpamës, me stilin e përsosur dhe modern, është individualiteti kompleks dhe komplet, kurse vepra e tij e madhe në sasi e në cilësi shprehje jo vetëm e dhuntisë po sidomos është shprehje e një pune të madhe, të mundimshme, sistemore e të disiplinuar, shprehje e një thellësie mendimesh e ndjenjash pambarimisht të pasura e të larmishme.

Shkruan ashtu siç thotë Çehovi: *që fjalët të ndihen ngushtë, kurse mendimet gjerë.*

Fjalët kyçe: shkrimtari, gjuha, stili, ligjërimi, mendimi...

Rexhep Qosja është krijues i madh me vëllimin e veprave, me vizionin largpamës, me stilin e përsosur dhe modern, është individualitet kompleks dhe komplet, kurse vepra e tij e madhe në sasi e në cilësi është shprehje jo vetëm e dhuntisë po sidomos është shprehje e një pune të madhe, të mundimshme, sistemore e të disiplinuar, shprehje e një thellësie mendimesh e ndjenjash pambarimisht të pasura e të larmishme.

Shkrimtari, Rexhep Qosja shkruan romane që nuk i gjen në letërsinë shqipe, trajton tema të pa trajtuara në letërsinë shqipe, tema që e intrigojnë, që e shqetësojnë dhe që e provokojnë thellë lexuesin dhe, pa dyshim, që kanë rëndësi dhe kuptim për njeriun shqiptar dhe për njeriun në përgjithësi. Shkruan ashtu siç do të thoshte Çehovi: *që fjalët të ndihen ngushtë, kurse mendimet gjerë.*

Shkrimet e tij letrare, historiko-letrare, kritiko-letrare, që nga fillimet e tij krijuese dhe ato më të vonshmet, kanë hapur mundësi të gjera diskutimi, sheshimi, debatimi, ashtu siç ka ndodhur edhe me ato për probleme nga më të ndryshme shoqërore e kulturore në përgjithësi, kanë hapur mundësi për të vënë paralele krahasuese hapësinore e kohore.

Mendimi kritik i Rexhep Qosjes për shumë nga ato çështje letrare e jo letrare edhe sot është i ri e do të mbetet i ri edhe më tutje, edhe pse shumë nga ato sot marrin kuptime të ndryshme dhe ende nuk janë definuar saktësisht. Në romanet e tij, pos të tjerash, ndeshet edhe ky mendim: *Në prozën moderne dhe postmoderne s'ka të pamundshme qoftë kuptimore, pëmbajtësore, qoftë formale strukturore, qoftë gjuhësore e stilistike. Trajtat e vjetra, klasike, realiste, të romanit janë harxhuar, përdoren më shumë prej mediokriteve. Në romanin e sotëm të ri mund të futen të gjitha gjinitë letrare, të gjitha llojet, të gjitha përbërjet, të gjitha dijet e artet. Romani i sotëm është enciklopedi letrare, artistike e diturore. (Te fshehtat e treguara, 124)*

Moto e veprës së tij është, *qëllimi i artit është estetik*. Të gjitha idetë duhet t'i shërbejnë artit, ai nuk guxon t'i nënshtrohet asnjë ideje, as shoqërore, as kombëtare e as etike, aq më pak asaj politike, sepse ashtu ai mund të bëhet shkrimtar i njëanshëm, i varur, nën zgjedhën partiake e qëndrimi i tij duhet të jetë gjithmonë mospajtues, kritik dhe ironik. Shkrimtari Rexhep Qosja edhe në romanet e tij e ka dëshmuar këtë përcaktim: ai është shkrimtar mospajtues, i paanshëm, objektiv, ironik dhe domosdoshmërisht kritik.

Shkrimtari Rexhep Qosja i ka mbetur parimor vetes dhe parimor estetikës së tij. Ai i ka siguruar, me qëndrimin e tij, status të pavarur vetes dhe status të pavarur veprës së tij, përgjithmonë, pra edhe me pesë romanet e tij të vëllimshme. (Islamaj, 2021: 33)

Lidhja midis strukturës dhe kuptimit, siç dihet, është thelbësore në studimin e veprës letrare. Kjo lidhje në romanet e Rexhep Qosjes është më tepër se lidhje – është varësi e kuptimit prej strukturës. Më drejt e thënë struktura dhe kuptimi, në të vërtetë përbëjnë njësishtëmëri të kuptimësuar në një vepër artistike, sepse struktura krijon kuptimin e kuptimi kushtëzon strukturën. (cit. Islamaj, 2021: 33)

Siç do të thoshte gjuhëtari i njohur kroat, Radoslav Katičić, qasja ndaj veprës letrare, në linguistikën moderne sot, depërton deri në përmbajtjen mendimore, deri te mesazhi që bart vepra artistike.¹ Prandaj, analiza gjuhësore në romanet e Rexhep Qosjes nuk kufizohet domosdo në përcaktimin e veçorive “formale”, por depërton në përmbajtjen e tyre, sepse struktura e veprës letrare është pjesë e strukturës gjuhësore. Struktura e veprës letrare është strukturë e botës së përfytyruar që është bërë e magjishme përmes gjuhës. I prirë prej këtij mendimi, ky qëllim, prandaj, është pikërisht zbulimi i kësaj bote të magjepsur gjuhësisht, është zbulimi i veçorive gjuhësore-stilistike të romaneve të Rexhep Qosjes, njërit prej shkrimtarëve më të mëdhenj në kulturën shqiptare. Mund të thuhet kështu sepse romanet e Rexhep Qosjes paraqesin thesarë të vërtetë gjuhësorë e stilistikë, paraqesin vlerë të pakalueshme letrare artistike.

Në rrafshin **leksiko-stilistik** bien në sy sidomos përfshirja e gjerë e leksikut ekspresiv, leksikut emocional, leksikut të vjetëruar, vulgarizmave, neologjizmave stilistikë, sidomos i atyre të krijuar nga vetë shkrimtari, që janë vërtet shumë. Analiza e tekstit letrar të shkrimtarit Rexhep Qosja përfshin të gjitha shtresat e leksikut, nga leksiku i vjetruar -fjalë, shprehje dhe ndërtime e deri te krijimet gjuhësore vetjake. Duhet të theksohet posaçërisht se njëra nga veçoritë e shquara të romaneve të tij është shfrytëzimi dhe krijimi i neologjizmave të shumtë. Krijimi i fjalëve të reja mbi bazën e fjalëformimit të shqipes paraqet veçori që është e përshtirë edhe në gjithë krijimtarinë e tij studimore, publicistike e sidomos letrare. Në këtë drejtim ai ka arritur të pasurojë dhe të freskojë gjuhën shqipe me numër të përfillshëm leksemash, shprehjesh e ndërtimesh të reja sintaksore.

Fjalët e vjetruara, ngjyrosin historikisht kohën dhe hapësirën, kurse neologjizmat stilistikë, shpalosin mundësitë e pakufishme krijuese të shqipes, ndërkaq si të parat, ashtu edhe të dytat i japin vlerë stilistike, ngjyrim të theksuar shprehës e emocional, tekstit letrar artistik të Rexhep Qosjes.

Në rrafshin morfo-stilistik, ku përfshihet përdorimi i kategorive morfologjike si dhe vlera e tyre stilistike, shkrimtari ka aktualizuar stilistikisht të gjitha kategoritë gramatikore prej emrit, mbiemrit, foljes, ndajfoljes e deri te fjalët ndihmëse duke shquar përdorimin e tyre në kontekste të shumta, të gjera e të larmishme stilistike. Shquan sidomos përdorimi stilistik i mbiemrave dhe i formave, i kohëve dhe i mënyrave foljore, kurse me theks të vaçantë këtu duhet të përmenden metafora gramatikore dhe sinonimia gramatikore. Këto kategori do të vështrohen stilistikisht, përmes figurave gjuhësore e stilistike.

Vëmendje e veçantë këtu i është kushtuar dendurisë së paraqitjes së dukurive të ndryshme në rrafshin sintaksor-stilistik. Është shquar posaçërisht saktësia dhe ngjeshja e tekstit, përmes të cilave zgjerohet ose ngushtohet shprehja gjuhësore duke arritur kështu njëkohësisht saktësinë semantike dhe ngjeshjen sintaksore të shprehjes. Janë vështuar, po kështu, shmangiet stilistike

¹ Cit. Islamaj/Sh. f.33; Radoslav Katičić, *Književnost i jezik*, “Umjetnost rječi” 3, Zagreb, 1968

në nivelin gramatikor. Megjithatë, vëmendja kryesore i është kushtuar figurave sintaksore me përdorim më të dendur dhe më ekspresiv siç janë figurat shtuese, si: grumbullimi, shkallëzimi, epiteti, epifora, dyfishimi; figurat e mungimit si: elipsa, reticenca pauza; figurat e kembimit, pyetjet retorike, zhvendosjet, anasjella, paralelizmi. Të shohim një tekst me larmi fjalish, të shumtat fjali të thjeshta, ku realizohet një shkallëzim shprehës dhe figura e përsëritjes.

Idioti, Zifti dhe Belbani e kalojnë vijën Mazhino!

Oh, Idiot! Gjithmonë idiotët shkaktajnë dhembjet më të mëdha!

Turma është ngjeshur.

Turma është zhveshur!

Turma është tendosur!

Nuk dëgjohet zë.

Nuk zgërdhihet kush.

Nuk kalon veturë, autobus a kombibus.

Nuk shihet polic.

Nuk shihet automjet i ndihmës së parë! As automjet i rrugës së fundit, i Morgut, që të çon në Varret e Mëdha.

*Përmendorja e Skënderbeut shikon diku larg, larg. Çka të shikojë tjetër përpos Kështjellës së Krujës të rrethuar nga ushtria e Sulltan Mehmetit. **Nata, 39.***

Në rrafshin semantiko-stilistik analizohen sinonimia e antonimia si dukuri me denduri të lartë përdorimi në të gjitha romanet e Rexhep Qosjes. Shkrimtari përdor numër të madh sinonimesh, me të cilat siguron saktësinë e shprehjes, shprehësinë e vlerat stilistike si dhe mënjanon përsëritjen e leksikut të njëlojshëm, duke e pasuruar tekstin nga ana semantike e leksikore. Megjithatë, qëllimi im këtu është analiza e figurave semantike që shënjojnë stilistikisht tekstin. Do të analizohen figurat semantike në kuptim të ngushtë si figurat e kundërvënies: antonimia, antiteza, paradoksi dhe antimetabola, si dhe figurat semantike të krahasimit.

Kur është fjala për tropet, vëmendja më e madhe i është kushtuar metaforës, si më e përfaqësuar, pastaj alegorisë, personifikimit, perifrazës dhe parabolës. Metaforat, vërtet zënë vend meritore, sepse siç thuhet nga studiuesit e saj, janë shprehja më e thellë e shpirtit dhe e intuitës së njeriut ndër shekuj. Në romanet e Rexhep Qosjes ajo ndihet “mbretëreshë” ndër figurat e tjera të shumta që mbushin romanet e tij.

Në mbështetje të veçorive gjuhësore-stilistike në të gjitha nivelet, mund të themi se shkrimtari Rexhep Qosja, ka arritur të shkruajë romane sipas gjedheve të prozës së sotme romanore, në rrafsh global-moderne dhe postmoderne. Edhe pse stili i shkrimit të tij në segmente të caktuara ka ngjashmëri me gjedhet e tij të parapëlqyera, mund të thuhet se megjithatë ai ka arritur të ndërtojë stilin e tij plotësisht vetjak, plotësisht të veçantë e të ngjashëm vetëm me vete, me vlera të larta artistike. Origjinaliteti i romaneve të tij shprehet posaçërisht në shprehjen dhe në formën stilistike. Ai ka sjellë në letërsinë shqipe gjuhë të re dhe mënyrë të re rrëfimi, ka sjellë roman të ri.

Që në romanin e parë “Vdekja më vjen prej syve të tillë” të shkrimtarit Rexhep Qosja, janë vërejtur shënjeshtër stilistikë të cilët, në masë më të madhe ose më të vogël, kanë shquar individualitetin e tij krijues artistik. Në të vërtetë, stili i tij shquan jo vetëm në romanet, por edhe në gjithë krijimtarinë e tij studimore e letrare, pavarësisht nga zhanri a nga gjinia. Në romanet e tij shprehja gjuhësore ngjishet theksueshëm me fjalë, ndërtime e frazeologji shprehëse-stilistike, ndërsa më së dukshmi shquhet prirja për përdorimin e krahasimeve dhe ndërtimeve dy, tri e më shumë gjymtyrëshe të organizimit ritmik të tekstit përmes emrave, mbiemrave dhe foljeve. Në këto veprime të shkrimtarit zbulohet ndjeshmëria e tij gjatë përzgjedhjes gjuhësore dhe ndjeshmëria ndaj vlerave shprehëse e sugjestive, të cilat do të bëhen shënjeshtër të përhershme stilistikë në gjithë krijimtarinë e tij artistike, dhe jo vetëm. Ndërkaq, në kuadër të poetikës shquhet përdorimi i epiteteve në funksion të tipizimit, përkatësisht të simbolizmit, përdorimi i oksimoronit, që është njëra ndër figurat moderne-postmoderne

stilistike. Ndërthurja fabulore e romaneve të tij dëshmon kthesën e madhe në kohën e shpërbërjes së realizmit, përkatësisht braktisjen e rrëfimit realist tradicional, aktualizimin e zërit të narratorit, që kushtëzoi veprime të reja stilistike, përkatësisht strategji e teknika të reja moderne e postmoderne.

Romanet “Vdekja më vjen prej syve të tillë”, sidomos romanet “Një dashuri dhe shtatë faje” dhe “Nata është dita jonë”, sipas mbizotërimit të shënjesve stilistikë, përdallohen edhe me elemente të shquara impresioniste dhe simboliste. Impresionizmi i këtyre romaneve e ka pikëmbështetjen narrative në ngjarje realiste, kurse formësimi i personazheve dhe i ndodhive nuk mbështeten në parimet e politikës realiste, por ka pikëmbështetje stilistike, që mund të përcaktohet si një hibridizim a përzierje e llojeve të ndryshme tekstore, që për rrjedhojë kanë kushtëzuar edhe llojin e ligjërimit në përgjithësi – ndërthurjen e ligjërimeve prej atij letrar e deri të ai publicistik. Në romanet e Rexhep Qosjes shquan një lloj “bashkëjetese” stilore, ku vend të rëndësishëm zënë edhe tekste të pavarura përshkruese me stilizim të lartë mbresëlënës. Brenda këtij konteksti me një varg veprimesh stilistike ndërtohen kundërvënie ironike, midis të cilave njëra nga këto teknika stilistike, me të cilat shkrimtari formëson shprehjen e vet, është shquarja e përmbajtjeve të ndryshme jo estetike. Në të gjitha romanet e Rexhep Qosjes në të cilat habia shquhet si veçori kryesore gjejmë shumë elemente të groteskut dhe të fantastikës, natyrisht jo në mënyrë të njëjtë. Ritmi i rrëfimit është përgjithësisht i shpejtë dhe dinamik, personazhet shpesh karikohen përmes krahasimesh nga më të ndryshmet, kryesisht të papritura, duke marrë funksion të karakterizimit ironik. Përpjekja për të arritur efekt stilistik, por edhe funksion estetik të shprehjes e në të njëjtën kohë edhe përpjekja për ritmizim risimtar e melodizëm mund të konsiderohen si shënjes themelore të stilit të Rexhep Qosjes.

Me shquarjen simboliste të sinestezisë, me përsëritjet e ndryshme të tingujve, fjalëve, shprehjeve dhe të elementeve të tjera arrihet ana sugjестive e gjuhës, prandaj shkrimtari këmbëngul shpesh në përdorimin e paralelizmave dhe të kiazmës, ndërsa brenda një stilizimi të tillë ngjishet metaforizimi, njëri ndër shënjesit e veçantë stilistikë të shprehjes së tij artistike, i arritur përmes frazemave e sidomos përmes shprehjes aforistike, në të cilat shquhet prirja e formësimit me kontrast, si në shembullin vijues:

O vëllai im! Mos harro se me mëkate jeohet më mirë se me mirësi. Zgjedh çka të duash: mirësinë që sjell përbuzjen apo mëkatin që sjell frikën e të tjerëve dhe ndërimin tënd. Po të kisha kohë tani do të dija të zgjidhja. Nuk është zemra e kurvës, zemra më e ftohtë në këtë botë. Jo. Jo. Zemra më e ftohtë në këtë botë është zemra e atij që e shpërdoron kurvën. Kjo botë i bën të lumtur ata që do të duhej t'i fundoste shtatë pashë dhe i bën të dëshpëruar ata që do të duhej t'i ngrite shtatë pash lart. Dhe, nuk janë këto të papriturat e saj po ligjet e saj! Nata, 33.

Loja me fjalët është përbërës i rëndësishëm i muzikalitetit të gjuhës së Rexhep Qosjes, kurse dyfishimi a trefishimi i cilësorëve, si njëri prej veprimeve të shpeshta stilistike, përplotëson karakterin e figurshëm të saj, sepse ato janë përqendrim i sugjektivitetit simbolik dhe menyrë për të shpirtëzuar natyrën dhe objektet.

Përrjashta bie një shi i imët, si kokrrat e orizit, që xhamit të dritares, përgjysmë të çelur, lëshohen me vrap teposhtë duke lënë pas vija të holla, të errëta. Vdekja, 83.

Brof në këmbë, sigurisht, syshastisur, syçakërritur, syzgurdulluar dhe e përthekoj krejt dhomën me shpresë se do t'ia gjej burimin zërit djallëzor. Vdekja, 85.

Në romanet e Rexhep Qosjes, njëra ndër teknikat bazë të rrëfimit, që shërben për ngadalësimin dhe shtresëzimin e ndodhive, që të shtyjë a të vonojë përfundimin e ngjarjes kryesore, është retardimi. Format kryesore të kësaj teknike që i gjejmë në romanet e tij janë digresioni, episodi dhe përsëritja, përshkrimet, pjesët lirike, monologët e brendshëm të personazheve dhe refleksionet e shkrimtarit. Retradimi i veprimit me shtesa përshkrimi, si veprim dallues stilistik i shkrimtarit, realizohet më së shpeshti në funksion të karakterizimit të personazheve, të ritmit dinamik dhe të një seri pamjesh të papritura me të cilat krijohet lëvizje e gjallë e veprimit të

ngjeshur rreth një situate dramatike. Një veprim i tillë dinamik zhvillohet edhe në rrafshin gjuhësor-stilistik përmes dyfishimit të foljeve dhe të fjalive të ngjeshura eliptike.

Kur i kishte gjurmuar – kot të katër qoshet, Kuçedra ishte ndalur në mes të Xhamisë, ishte dredhur e përdredhur mbarë e mbrapshtë dhe kishte bërtitur të madhe, aq të madhe saqë ishte dridhur Xhamia... Një dashuri, 276.

Në romanet e Rexhep Qosjes, erudicioni, pasuria e tij mendimore e ndjenjore, përvoja e gjatë, e pasur dhe e papërsëritshme, e paraqitur edhe përmes ndërteksteve dhe, sidomos, citateve nga mendimet e të tjerëve, janë të lidhura mes vete në mënyrë të pandashme, parimore dhe funksionale. Ato janë ndërlidhur plotësisht natyrshëm dhe në vendin e duhur duke zhvilluar varg të pasur asociativ të mendimeve dhe të krahasimeve me të cilat shkrimtari zbulon pikëpamjet e tij mbi botën, mbi artin, mbi estetikën dhe, sidomos mbi ngjarje e dukuri shoqërore, mbi personazhe letrare.

Në gjuhën e pesë romaneve të vëllimshmë me rreth 3000 faqe, shkrimtari shpesh aktualizon leksik të vjetruar dhe fjalë dialektore duke realizuar efekte të fuqishme stilistike, ndërsa në rrafshin sintaksor kohët shprehëse foljore siç janë koha e kryer e thjeshtë dhe e pakryera, ngjyrosin në mënyrë sugjестive rrëfimin.

Në frazeologjinë e tij mund të vërehet ndikimi i gjuhës bisedore, i thjeshtligjërimit dhe i gjuhës popullore në përgjithësi, por edhe ndikimi i frazeologjisë letrare, intelektuale, kurse si tregues kryesorë veçohen metaforizmi, asociacioni dhe aforizmi. (Po aty, 39)

I shquar me ndjenjë të fuqishme gjuhësore, me dinamizim ritmik e melodik, me përzgjedhje sugjестive gjuhësore, me figurshmëri, me lojë gjuhësore, me risime fjalëformuese si dhe me shprehje ironizimi, me shfrytëzimin e mundësive dhe të ligjërimeve të ndryshme gjuhësore në funksion stilistik, stili i Rexhep Qosjes dallon dukshëm nga stili i shkrimtarëve të tjerë shqiptarë, duke u dalluar si stil i lartë e stil i lartë do të thotë shumësi e lartë e vullnet i lartë: prirje për sugjestion të fuqishëm dhe energji për shprehje të lirë.

Referencat

- [1]. Islamaj, Shefkije; Ligjërimi, gjuha dhe stili – Në krijimtarinë letrare moderne dhe postmoderne të Rexhep Qosjes – 2021
- [2]. Lloshi, Xhevat; Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika- 2005
- [3]. Islamaj, Shefkije; Gjergj Fishta – gjuha dhe stili I- 2012
- [4]. Islamaj, Shefkije; Gjergj Fishta – gjuha dhe stili II- 2012
- [5]. Islamaj, Shefkije; Gjuha e Jakov Xoxës – Veçori leksiko-semantike dhe stilistike – 1999
- [6]. Beqiri, Xhavit; Lahuta... e Fishtës (Gjuhë dhe stil) – 2015
- [7]. Krasniqi, Nysret; Letërsia e Kosovës 1953 – 2000 – 2016